



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 21 Dhjetor 2021

Nr: 115

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE  
NR. 01/1, DATË 17.12.2021 DREJTUAR KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE, PËR VENDOSJE SANKSIONI ADMINISTRATIV

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 21.12.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i kërkesës nr. 01/1, datë 17.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”

**BAZË LIGJORE:** Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” dhe 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenet 34, 35 e 36 të vendimit nr. 3, datë



06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”; vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, në datën 19.03.2021, është raportuar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2368, ndaj kandidatit për deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Alqi Bllako dhe Bashkisë Tiranë, për kryerjen e një aktiviteti elektorale në ambientet e bibliotekës “Moikom Zeqo”.
2. Në bazë të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri vendosi të fillojë procedurën administrative me palë: Organizata “Qëndresa Qytetare” në cilësinë e kërkuarit dhe z. Alqi Bllako, Bashkia Tiranë, Biblioteka “Moikom Zeqo” dhe Partia Socialiste e Shqipërisë, në cilësinë e subjekteve të raportuara.
3. Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga ana e komisionerit, u thirr dhe u dëgjua për të parashtruar pretendimet e tij administratori i njësisë administrative nr. 2, Tiranë, z. Florian Pullazi, i cili mohoi faktin e zhvillimit të veprimtarisë më qëllime zgjedhore në bibliotekën “Moikom Zeqo”. Në identifikimin e administratorit si palë në proces, e në përfundim të hetimit në cilësimin e tij si person përgjegjës për zhvillimin e aktivitetit elektorale në mjediset e bibliotekës, komisioneri i është referuar parashikimeve të nenit 33.2, pika 6, të vendimit nr. 25661, datë 02.07.2018 të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliqaj “Për një ndryshim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”, “Administratori i Njësisë Administrative siguron një mirëadministrim të këndeve të lojrave, terreneve sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë”.
4. Me vendimin nr. 467, datë 11.11.2021 “Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e bibliotekës “Moikom Zeqo”, me pjesëmarrjen e kandidatit për deputet z. Alqi Bllako”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur



konstatimin e shkeljes nga ana e z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Tiranë.

5. Bazuar në nenin 19, shkronja “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 35, në vendimin nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, nëpërmjet kërkesës nr. 01, datë 17.12.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kërkon të vërë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe në zbatim të pikës 1, të nenit 171, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkon vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Florian Pullazi, Administratorit të Njesisë Administrative nr.2, Tiranë, në vlerën 5000 (pesë mijë) Lekë.
6. KAS-i, pasi caktoi me short relatorin z. Elvis Çefa, vendosi të pranojë për shqyrtim kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe caktoi datën 21.12.2021 për shqyrtimin e tij. Në seancën e datës 21.12.2021, në praninë e përfaqësuesve të administratës së KQZ-së, u paraqit, parashitroi pretendimet dhe dha sqarimet e nevojshme z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

#### **KAS-i konstatoi:**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është organi kompetent për të shqyrtuar kallëzimet e paraqitura nga personat fizikë/juridikë, sipas pikës 2 të nenit 9 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
2. Me vendimin nr, 107, datë 26.7.2021 të KAS ka vendosur “Shfuqizimin e vendimit nr. 424, datë 12.07.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Tiranë, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, duke rekomanduar “Riçeljen e hetimit administrative të



plotë dhe të gjithanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative, duke u garantuar të drejtat palëve në procesin administrative, subjekteve të kallëzuara në denoncimin në fjalë (kandidatëve për deputetë, subjektit zgjedhor përkatës dhe bashkisë Tiranë).”.

3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të KAS, KSHZ ka nisur për herë të dytë hetimin administrativ për të arritur në përfundimin nëse në rastin e denoncuar ka ose jo shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Ndër të tjera, për nevoja të hetimit, KSHZ ka vlerësuar të arësyeshme t’i kërkojë informacion administratorit të njësisë administrative nr. 2, Tiranë në cilësinë e njësisë administrative në territorin e të cilës ndodhet biblioteka ku pretendohet të jetë zhvilluar aktiviteti i pretenduar nga subjekti ankues Qëndresa Qytetare.
4. Gjatë hetimit administrativ, në vlerësim të rrethanave të faktit dhe në interpretim të dispozitave përkatëse që rregullojnë kompetencat e administratorit të njësisë administrative, KAS arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ngarkimin me përgjegjësi të z. Pullazi nuk është i drejtë dhe i bazuar.
5. Referuar parashikimeve të nenit 33.2, pika 6, të vendimit nr. 25661, datë 02.07.2018 të kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për një ndryshim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”, *Administratori i Njësisë Administrative siguron një mirëadministrim të këndeve të lojrave, terreneve sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë*. Nga interpretimi i dispozitës në fjalë, nuk rezulton të jetë përcaktuar një kompetencë konkrete apo një marrëdhënie konkrete varësie të bibliotekës nga administratori i njësisë.
6. Në seancën e zhvilluar në KAS rezultoi se administrata e bibliotekës nuk ka asnjë lloj varësie hierarkike nga Administratori i njësisë bashkiake dhe po ashtu as ky i fundit nuk është personi i cili bën rekrutimin apo largimin nga detyra të personelit të bibliotekës. Punonjësit e bibliotekës janë punonjës të bashkisë Tiranë. Administrata e bibliotekës ka varësi administrative nga Drejtoria e Promovimit të Qytetit në bashkinë Tiranë, e cili është edhe drejtoria kompetente që miraton kërkesat për zhvillimet e aktiviteteve të ndryshme në bibliotekat e njësisë bashkiake të Tiranës.
7. Në pohimet e tij para KAS, në përgjigje të pyetjeve të bëra nga anëtarët, z. Pullazi deklaroi se ai është administrator i njësisë administrative dhe jo i bibliotekës, ai nuk ka asnjë kopetencë për të



miratuar leje për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në bibliotekë, një leje e tillë merret nëpërmjet një aplikimi online në faqen e bashkisë Tiranë dhe miratohet nga drejtoria e Promovimit të qytetit. Z. Pullazi madje deklaroi se ai nuk ishte aspak në dijeni të zhvillimit të aktivitetit të denoncuar në bibliotekën që ndodhet në territorin e njesisë së tij dhe se me këtë fakt ishte vënë në dijeni vetëm pasi ishte thërritur në hetim administrativ nga KSHZ.

8. Në analizë të sa më sipër, KAS vlerëson se Administratori i Njesisë Administrative nr. 2 Tiranë, z. Florian Pullazi nuk është personi ligjërisht përgjegjës për organizimin e punës dhe për rrjedhojë edhe të aktiviteteve të ndryshme në bibliotekën e njesisë administrative nr. 2. Për këtë arsye ndaj tij nuk ka vend për të ndërmarrë sanksion administrativ.
9. KAS vlerëson se hetimi i KSHZ për të bërë të mundur identifikimin e personave dhe përgjegjësive të tyre ligjore në përdorimin në kundërshtim me Kodin Zgjedhor të aseteve publike në këtë rast është i përciptë. Në kushtet kur për këtë rast ka një vendim të mëparshëm nga KAS, vendim i cili kishte dhënë orientime të qarta për mënyrën se si duhej proceduar, ishte detyrë e KSHZ që të zhvillonte një hetim të plotë dhe të gjithanshëm administrativ duke përcaktuar subjektin realisht përgjegjës për shkeljen konkrete të ligjit të konstatuar nga hetimi i kryer.
10. KAS vlerëson se vetëm pas një hetimi të plotë dhe shterues, i cili të ketë identifikuar personat realisht përgjegjës dhe përgjegjës të tyre konkrete sipas ligjit, mund të procedohet me kërkesën për vendosjen e sanksioneve administrative, nëse është rasti.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 45 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës nr. 01/1, datë 17.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

